

Sektor i veprave penale të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, sipas nenit 68 paragrafi 5 të Rregullores gjyqësore dhe nenit 41 të Rregullores së punës të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më **08.11.2021** miratoi konkluzionin mbi çështjet juridike të katër Gjykatave të apelit Shkup, Manastir, Gostivar dhe Shtip për harmonizimin praktikës gjyqësore:

K O N K L U Z I O N

Dispozita e nenit 108 paragrafi 1 të Kodit penal, për fillimin e parashkrimit të ndjekjes penale zbatohet te veprat penale që kryhen me paramendim ndaj fëmijës, përkatësisht me qëllim që subjekti pasiv – i dëmtuari ndaj të cilit është kryer vepra të jetë fëmijë.

Sektor i veprave penale